



Planuar / Doretzuar Punjueno/Prodato Received/Delivety	26.07.2023	3	vet. sh. yhat
Organ /Njesia Organ /Jednitca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtupja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
KPM SHCK	53.69	2023	1/4



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.872/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.872/2023 të datës 21.06.2023 të ankueses \_\_\_\_\_ me adresë \_\_\_\_\_

kundër Vendimit Nr.08/27-667-2023 të datës 22.05.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 26.07.2023, mori këtë.

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër me numër A.nr.872/2023 e datës 21.06.2023, e parashtruar nga ankuesja \_\_\_\_\_

A r s y e t i m

Ankuesja \_\_\_\_\_ me datë 21.06.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.08/27-667-2023 të datës 22.05.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve të Komisionit Qendror Zgjedhor, kundër procedurës së zhvilluar për konkursin e shpallur për pozitën "Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Lipjan" nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, (tani e tutje KQZ).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPM SHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave, me datë 30.06.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankese te KQZ, ndërsa me datë 07.07.2023, KPM SHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankese se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosjen e kësaj lëndë, ka administruar këto prova: Vendimin e Këshillit A.nr.824/2023 të datës 24.07.2023; Ankesën A.nr.872/2023, e datës 21.06.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin e shpallur nga KQZ të datës 31.01.2023; Vendimit Nr.08/27-667-2023 të datës 22.05.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 30.06.2023; Përgjigjen në kërkesë të datës 04.07.2023; Njoftimin për vazhdimin e afatit të konkursit; Njoftimet e zyrës së personelit të datës 20.03.2023; Njoftimet e zyrës së personelit të datës 28.03.2023; Formularin për përcaktimin e kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë të datës 07.03.2023; Formularët e vlerësimit për hartimin e listës së ngushtë; Testet me shkrim të kandidatëve në procedurë; Vendimi për themelimin e komisionit përzgjedhës i datës 02.03.2023; Raporti i Kryesuesit të Komisionit përzgjedhës mbi përgatitjen e listës së ngushtë i datës 07.03.2023; Aplikacionin e kandidatës [redacted] i datës 03.02.2023 me dokumentacionin e bashkangjitur; Vërtetimin e lëshuar nga Procredit Banka Kosovo i datës 01.09.2015; Shkresën e datës 04.01.2023 lëshuar nga FINCA i datës 04.01.2023; Shkresën e datës 30.06.2023 lëshuar nga FINCA i datës 04.01.2023; Aplikacionin e kandidatit [redacted] i datës 08.02.2023 me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e kandidatës [redacted] i datës 10.02.2023 me dokumentacionin e bashkangjitur; Vërtetimin e lëshuar nga KQZ për periudhën nga 02.09.2021-30.11.2021; Vërtetimin e lëshuar nga KQZ për periudhën nga 15.01.2021-10.03.2021; Vërtetimin e lëshuar nga KQZ për periudhën nga 10.09.2019-10.11.2019; Vërtetimin e lëshuar nga KQZ për periudhën nga 17.05.2017-15.11.2017; Vërtetimin e lëshuar nga KQZ për periudhën nga 30.08.2009-30.08.2011; Vërtetimin e datës 30.11.2014 lëshuar nga DPT Motori; Kontratë pune e datës 01.10.2021 lëshuar nga DPT Motori; Vërtetimin e lëshuar nga KQZ për periudhën nga 30.08.2009-30.08.2011; Vërtetimin e lëshuar nga Dukagjini i datës 25.05.2009; Aplikacionin e kandidatit L.S i datës 10.02.2023 me dokumentacionin e bashkangjitur; Formularin e Vlerësimit të rezultateve në punë i datës 19.12.2022 dhe të datës 22.06.2021 lëshuar nga ElektriKa Mont-Lipjan; Vërtetimin e datës 19.12.2022; Aplikacionin e kandidatit [redacted] i datës 09.02.2023 me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e kandidatit [redacted] i datës 13.02.2023 me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e kandidatit [redacted] i datës 02.02.2023 me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e kandidatës [redacted] i datës 10.02.2023 me dokumentacionin e bashkangjitur; Referencën e datës 07.02.2023 lëshuar nga UBT; Referencën e datës 30.10.2015 lëshuar nga Maxi Hipermarket; Aplikacionin e kandidatës M.R-B i datës 14.02.2023 me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e kandidatit [redacted] i datës 14.02.2023 me dokumentacionin e bashkangjitur; Formularët Form.KQZ-R-08a për vlerësimin individual të kandidatëve nga anëtarët e Komisionit; Formulari Form.KQZ-R09 për përmbledhjen e vlerësimeve individuale; Formularin Form.KQZ-R-09 për renditjen përfundimtare të kandidatëve; Raporti Final i rekomandimit i datës 27.03.2023; Njoftimin për kandidatin e suksesshëm i datës 28.03.2023.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se objekti për të cilin për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankueses [redacted] është bërë i pamundur, *sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përmes konkursit të datës 31.01.2023 ka shpallur konkursin publik për gjashtë (6) pozita të lira, prej tyre edhe pozitën me

shifër "KQZ-06/2023-Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Lipjan", ndërsa sipas aplikacionit të datës 03.02.2023 konstatohet se në këtë konkurs për pozitën e lartcekur ka aplikuar edhe kandidatja tani e tutje në cilësi të ankueses.

Ankuesja me datë 21.06.2023 të parashtruar në Këshill kundër Vendimit Nr.08/27-667-2023 i datës 22.05.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komisionit Qendror Zgjedhor, pretendon se procedura e zhvilluar e rekrutimit për pozitën "KQZ-06/2023-Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Lipjan" është përcjellë me shkelje materiale dhe procedurale kurse kandidati i përzgjedhur sipas njoftimit të datës 28.03.2023 nuk është bërë mbi bazën e meritës, me kërkesën që të aprovohet ankesa e ankueses, lënda të kthehet në rishqyrtim në Njësine për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore si dhe të anulohet Njoftimi për kandidatin e suksesshëm.

Kolegji i Këshillit, nga administrimi shkresave të parashtruara nga kandidatët për pranim në shërbimin civil, ka gjetur se për të njëjtën procedurë të rekrutimit dhe për pozitën e njëjtë "KQZ-06/2023-Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Lipjan" të zhvilluar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka parashtruar ankesë me datë 08.06.2023 kandidatja tjetër në procedurë, ndërsa Këshilli me qëllim të shqyrtimit të ankesës së saj me datë 24.07.2023 ka nxjerrë Vendimin A.nr.824/2023 përmes të cilit e ka aprovuar ankesën e ankueses K.I të datës 08.06.2023, ndërsa ka anuluar Njoftimin për kandidatin e suksesshëm të datës 28.03.2023, fazën e testimit me gojë dhe me shkrim si dhe Raportin e përgatitjes së listës së ngushtë të datës 07.03.2023, kurse e ka obliguar Komisionin Përzgjedhës në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të ndërmarr veprimet e nevojshme që procedurën e rekrutimit për pozitën "Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Lipjan", ta zhvillojë përsëri nga faza e përgatitjes së listës së ngushtë, andaj në rrethanat e rastit konkret lidhur me pretendimet ankimore të ankueses sikurse edhe me objektin e shqyrtimit të ankesës së saj, gjegjësisht konkursin e zhvilluar si dhe njoftimin e datës 28.03.2023 për kandidatin e suksesshëm për pozitën "Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Lipjan" Kolegji i Këshillit ka vendosur paraprakisht në mënyrë meritore, gjegjësisht aktet e kontestuara nga pala ankueses i ka anuluar, ndërsa Komisionin Përzgjedhës në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve e ka detyruar ta zhvillojë përsëri konkursin që nga faza e hartimit të listës së shkurtë, ku për rrjedhojë kjo vendimmarrje ka efekte juridike edhe ndaj ankueses pasi që ka qenë kandidate në procedurë të rekrutimit.

Prandaj nga se u tha si më lartë, pas rrethanave të krijuara juridike, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë" dhe mbi këtë bazë është konstatuar fakti së procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës së ankueses të datës 21.06.2023 duhet të përfundojë, pasi që Këshilli përmes Vendimit të datës 24.07.2023 me shifër A.nr.824/2023 ka vendosur për objektin e njëjtë të shqyrtimit dhe në rastin konkret është bërë i pamundur apo i kotë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

Lënda me numër **A.nr.872/2023**

**Flakron Gashi**



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Eshref SHABANI**



Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komisionin Qendror Zgjedhor, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.